

KËRKIME GJUHËSORE

Evis HUDHËRA

SINONIMIA TE MBIEMRAT ME –SHËM DHE ATA PREJPJESORË

Në ditët e sotme, në gjuhësinë shqiptare, janë shtuar shumë studimet për klasa fjalësh, për nënklasa e grupe të ndryshme leksiko-gramatikore. Edhe për *mbiemrin* këto studime janë të shumta e të ndryshme, të pjesshme e përfshirëse. Klasa e mbiemrave, jo vetëm ka njohur pasqyrim që në gramatikat e para të shqipes, por në vijueshmëri është trajtuar nga shumë këndvështrime: nga ana morfologjike, nga ana semantike, nga ana funksionale, nga ana fjalëformuese etj. Punimi ynë ndalet te një nga dukuritë më universale semantike, *te sinonimia e mbiemrave prejpjesorë dhe mbiemrave prejfoljorë me –shëm, duke u bazuar te “Fjalori sinonimik i Gjuhës shqipe”*2004.

Mbiemrat kuptimisht nuk janë të një tipi, ndaj po ndalemi shkurt te klasifikimi kuptimor i tyre.

Mbiemri në gjuhën shqipe është një nga klasat leksiko - gramatikore që paraqet një fushë të gjerë studimi për këdo, për gjuhëtarin e për mësuesin, për studiuesin e për dashamirësin e gjuhës. Mbiemri, edhe pse është studiuar gati deri në hollësi, paraqet dukuri të shumta e interesante që kanë tërhequr edhe vëmendjen tonë. Këto dukuri mund të lidhen me të gjitha rrafshet gjuhësore: *me rrafshin morfologjik, me rrafshin leksikor e kuptimor, me rrafshin sintaksor, me rrafshin stilistikor, me rrafshin fjalëformues* etj.

Në qoftë se mbështetemi në “*Gramatikën e gjuhës shqipe*”¹, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, por edhe në dhjetëra punime të tjera të plota dhe të pjesshme¹ mbiemrat klasifikohem në bazë të dy kriterëve: *sipas kuptimit të tyre leksikor dhe sipas veçorive të tyre morfologjike*.

1. *Klasifikimi sipas kuptimit leksikor*: Duke u nisur nga ajo se çfarë tipi ata emërtojnë, gjithë mbiemrat e gjuhës shqipe ndahen në dy grupe të mëdha:

a. Në *mbiemra cilësorë* (mal i lartë), “që tregojnë cilësi” dhe që “emërtojnë veti a cilësi të cilat rroken drejtpërsëdrejti me shqisa ose që janë vetëm të mendueshme, të përfytyrueshme”².


b. Në *mbiemra marrëdhëniorë* (dashuri atërore), “që tregojnë marrëdhënie” dhe që “japin tiparin e sendit, emrin e të cilit karakterizojnë, nëpërmjet emërimit të marrëdhënieve të këtij sendi me një send tjetër ose me një rrethanë, me një veprim a me një numër”³.

Brenda këtyre dy grupeve gjenden shumë nëngrupe me mbiemra prejfoljorë, të cilët siç e thotë termi, janë mbiemra që janë formuar nga një temë fjalëformuese folje:

¹ Shih më gjerë bibliografinë shkencore të konsultuar, që pasqyrohet në fund të punimit.

² *Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2002, f. 155.

³ *Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2002, f. 156.



2. *Klasifikimi sipas veçorive morfologjike.* Një nga veçoritë strukturore të mbiemrit në gjuhën shqipe është *nyjzimi*. Sipas kësaj veçorie mbiemrat e shqipes ndahen në dy grupe:

a. *Grupi i mbiemrave të nyjshëm*, tek të cilët nyja është bërë pjesë a pandashme dhe e domosdoshme e strukturës së tyre. Këtu hyjnë gjithë mbiemrat e parmë, gjithë mbiemrat e formuar me prapashtesa *-(ë)m(ë)*, *-shëm*, *(ë)t(ë)*; gjithë mbiemrat e formuar nga pjesorja pa ndonjë prapashtesë etj.⁴

1. Nëngrupi i mbiemrave prejfoljorë me nyjë dhe me prapashtesën – **shëm**⁵, si ndjeshëm, i pijshëm,; i djegshëm, i kapshëm, i mundshëm, i përkulshëm, i rrjedhshëm, i tretshëm; i kapërcyeshëm, i lyeshëm, i shkëlqyeshëm, i thyeshëm, i ushqyeshëm etj.

P.sh. SHKËLQËESHËM (i) mb. 1. Që lëshon dritë të fortë; që shkëlqen si dritë. Shkëlqyes. Shkëlqyer (i). Ndrishtëm (i). Shndritshëm (i). *Iliri pa me bishtin e syrit dhe vërejtë një kuti metalike të shndritshme në duart e Sonit.* (Let. art.). Përshkënditës. Shkëlqimtar poet. 2. fig. → Shkëlqyer (i)_{2,3} mb. fig.

2. Nëngrupi i mbiemrave prejfoljorë me nyjë dhe me prapashtesën e re – ueshëm, si avullueshëm, i çmueshëm, i dëshirueshëm, i mrekullueshëm, i trishtueshëm, i admirueshëm, i blueshëm, i shkrueshëm, i dënueshëm, i lavdërueshëm, i dëgjueshëm.

P.sh. TRISHTËESHËM (i) mb. Që shpreh trishtim; që të trishton. Pikëlluar (i). Mjerueshëm (i). E gjeta në një gjendje të mjerueshme, të sëmurë e pa një njeri aty pranë që t'i jepte një pikë ujë. (Let. art.). Mjerruar (i).

Formimi i mbiemrave me nyjzimin e pjesores së foljes, zë vend të veçantë jo vetëm në grupin e mbiemrave të gjuhës shqipe, por edhe në faqet e *Fjalorit sinonimik të gjuhës shqipe, 2004*. Ata shfaqen si një grup i përcaktuar qartë, me tipare specifike e të spikatura dhe në fjalor përbëjnë rreth 2/3 e gjithë mbiemrave prejfoljorë sinonimikë.

Kjo masë e madhe mbiemrash të tillë dhe tiparet e tyre na kanë shtyrë që të ndalemi pikërisht te mbiemrat prejpjesorë dhe ata prejfoljorë që mbarojnë me – *shëm* apo – *ueshëm*.

Struktura morfologjike e mbiemrave prejpjesorë, është dybërthamshme e tipit *nyjë e përparme + temë e pjesores*, që do të thotë se këto njësi janë të analizueshme, të zbërthyeshme si nga ana ndërtimore, ashtu dhe nga ajo kuptimore. Këta mbiemra do të futen në nëngrupin e derivateve leksiko-

⁴ Shih më gjerë *Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, Tiranë, 2002, f. 158.

⁵ Për këtë tip mbiemrash shih më gjerë P. Haxhillazi, *Vëzhgime mbi mbiemrat foljorë me prapashtesën –shëm në gjuhën shqipe*, në “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, II, Tiranë, 1972, f. 257-274.

SINONIMIA TE MBIEMRAT ME –SHËM DHE ATA PREJPJESORË

gramatikore, që përfshin formimet me ndajshitesa e pa ndajshitesa dhe me ndryshim të kategorisë leksiko - gramatikore⁶.

Studiuesi V. Memisha, thekson se *nyje e përparme + pjesore e foljes* krijon një model tematik fjalëformues të veçantë, por jo të panjohur për tema të tjera fjalëformuese. Ky strukturim u kundërvihet gjedheve të tjera fjalëformuese të shqipes, duke mbartur tipare që përcaktojnë se mbiemrat prejpjesorë janë krijuar në përputhje me ligjet e zhvillimit të gjuhës sonë. Ata tashmë, siç jemi shprehur, janë një klasë reale, e fuqishme në leksikun e përgjithshëm e normativ të kësaj gjuhe. Gjithashtu ky model tematik shërben si rrugë e hapur për krijimin e mbiemrave të rinj. Përdorimi i panumërt i këtyre mbiemrave si *leksik potencial*, në kapërcyell të kalimit nga njësi foljore si pjesore te njësi mbiemërore në stile e ligjërimi të ndryshme, është në të mirë të këtij argumentimi.⁷

Klasën e mbiemrave prejpjesorë mund ta ndajmë në dy gupe të mëdha: a. *Grupi i mbiemrave të mëvetësishëm* që funksionojnë si cilësorë e që janë ngulitur në përdorim dhe në traditën leksikografike gjejnë pasqyrim jo vetëm në fjalorët shpjegues, por edhe në ata dy- e më shumëgjuhësh.

Ata karakterizohen nga struktura kuptimore të qëndrueshme, nga zgjerimi e shumëfishimi i lidhjeve semantike, zhvillimi dhe zgjerimi i valencave fjalëformuese, duke krijuar fjalë të prejardhura, të përbëra, të përngjitura apo të substantivuar. Këta mbiemra i takojnë shtresës reale të leksikut të gjuhës shqipe.

Grupin e dytë e përbëjnë *mbiemrat që kanë përdorim kontekstual*, një dukuri tepër e njohur dhe në gjuhët e tjera. Sintagma të shumta bëhen treguese të gjallimit të tyre në gjuhë, duke qenë të formuar strukturalisht (nyja e përparme i shkëput nga pjesoret), të formësuar morfologjikisht (kanë gjini, numër, rasë të gjymtyrës drejtuese). Ata shfaqin kështu dhe të ashtuquajturën *autonomi* kuptimore që synon drejt mëvetësisë edhe në këtë rrafsh.⁸ Ne nuk do të merremi me këta mbiemra, sepse ata akoma nuk kanë zënë vend në fjalorët e ndryshëm shpjegues apo dy- e shumëgjuhësh të shqipes.

Mbiemrat prejpjesorë dokumentohen në shkrim që në monumentet më të hershme të gjuhës shqipe. Ata si i gjithë leksiku i gjuhës shqipe, me vendin që zënë dhe me tiparet që i karakterizojnë, janë pasqyruar të procesit të gjatë të zhvillimit historik të shqipes, të periudhës parakombëtare dhe kombëtare të saj.

Mbiemra prejpjesorë, kuptimisht, *kanë aftësinë për të shënuar tiparin e rezultatit të veprimit të shprehur nga folja që përbën temën fjalëformuese të tyre*⁹, dhe kjo është veçoria themelore që i bashkon këta mbiemrat në një grup të madhe dhe me tipare të veçanta. Ata ruajnë kuptimin, trashëgojnë bërthamën kuptimore të foljeve përkatëse. Kjo është më e rëndësishmja në kuptimin tyre.

⁶ J. Thomai, Formimi i fjalëve dhe prejardhja kuptimore në gj. shqipe, SF, 3, 1983, f. 54.

⁷ V. Memisha, Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpjesorë në gjuhën shqipe, Gjirokastër, 1999, f. 88.

⁸ V. Memisha, Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpjesorë në gjuhën shqipe, Gjirokastër, 1999, f. 115.

⁹ V. Memisha, Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpjesorë në gjuhën shqipe, Gjirokastër, 1999, f. 99.

Duke u mbështetur në faktin që foljet e gjuhës shqipe ndahen në dy klasa të mëdha, në *folje kalimtare* dhe në *folje jokalimtare*,¹⁰ ato kanë kategorinë e diatezës (të cilën e kanë zakonisht foljet kalimtare): *diateza veprorë, diateza pësore, diateza vetvetore dhe diateza pësore*,¹¹ pra mund të themi se:

Mbiemrat prejpjesorë trashëgojnë semat kryesore kuptimore të foljeve, nga pjesoret e të cilave janë formuar dhe lidhen drejtpërdrejt me këtë kategori gramatikore të foljeve.

Mbiemrat prejpjesorë si njësi leksikore kanë kuptime të ndryshme, ata shprehin një shkrirje ndërmjet kuptimit kategorial "*japin tiparin e rezultatit të veprimit të shprehur nga folja që përbën temën fjalëformuese*" dhe kuptimeve të veçanta, të mbartura në çdo leksemë, me kuptime që formojnë tipologji kuptimore.

Vetë emërtimi mbiemra prejfoljorë do të thotë se këta mbiemra jo vetëm janë të lidhur dhe strukturalisht me foljen që shërben si temë fjalëformuese, por edhe trashëgojnë një numër shumë të madh semash prej tyre. Madje mbiemrat prejpjesorë apo mbiemrat e panyjshëm të formuar me *-(ë)s, -ues* i mbartin gati të gjithë semat foljore, duke u shtuar strukturës së tyre vetëm formulën shpjeguese mbiemërore:

CILËSÚES,-E mb. 1. Që cilëson dikë a diçka. Cilësor. Ky tipar, cilësor i karakterit dhe i sjelljeve, duhet çmuar e duhet kultivuar. (Let. mës.). 2. gjuh. → Cilësor,-e₂ mb. gjuh.

ÇMBËSHTJËLLË (i) mb. Që është çmbështjellë. Çmbledhur (i). Shpërdredhur (i). Zhdredhur (i). Zbuluar (i). Zhdërrjendur (i). – *Fijet e zhdërrjendura i mbështjellim prapë në një masur tjetër, se i përdorim për thekë. (Ligj. fol.).* Sthurur (i). Shtjelluar (i).

Ne po ndalemi vetëm te semantika e mbiemrave prejpjesorë dhe e mbiemrave prejfoljorë me *–shëm*. Mbiemrat prejfoljorë të formuar me prapashtesën *–shëm* janë karakteristikë e dialektit të gegërishtes, në të cilin dhe semantikisht shënojnë edhe tiparin e rezultatit të veprimit të shprehur nga folja, tipar që e shënojnë mbiemrat prejpjesorë. Në shqipen standarde ata janë diferencuar semantikisht. P. Haxhillazi shprehet se "në gjuhën e sotme shqipe mbiemrat foljorë me *–shëm* janë diferencuar në mënyrë të qartë semantikisht. Ata janë specializuar semantikisht duke mbajtur kuptimin që shënon tiparin e aftësisë së kryerjes së një veprimi ose të aftësisë dhe të mundësisë për t'iu nënshtruar një veprimi. Këtyre u shtohen edhe nuancat e tjera kuptimore si domosdoshmëria, pashmangshmëria dhe meritimi për t'iu nënshtruar një veprimi. Si të tillë mbiemrat foljorë me *–shëm*, dallohen nga formimet e tjera mbiemërore, por ky proces nuk ka përfunduar plotësisht. Në gjuhën e shkruar ende hasen formime të tilla që semantikisht e ruajnë karakterin tyre dialektor."¹²

Mbiemrave prejpjesorë apo një a disa shumë kuptimeve të tyre (nëse janë shumëkuptimësh) në toskërishte u përgjigjen përgjithësisht mbiemrat me *–shëm* në

¹⁰ *Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, Tiranë, 2002, f. 265.

¹¹ *Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, Tiranë, 2002, f. 270.

¹² P. Haxhillazi, *Vëzhgime mbi mbiemrat foljorë me prapashtesën –shëm në gjuhën shqipe*, në "Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe", II, Tiranë, 1972, f. 271.

SINONIMIA TE MBIEMRAT ME –SHËM DHE ATA PREJPJESORË

gegërishte. Në gjuhën standarde këta dy tipa fjalëformuese janë diferencuar kuptimisht. Por në Fjalor mungojnë shumë njësi që ekzistojnë si në ligjërime të ndryshme. Fjala vjen, ne gjejmë mbiemrin *i acaruar*, por jo *i acarueshëm*¹³. Këtë fjalë nuk e gjejmë as në *Fjalorin e gjuhës shqipe*¹⁴, as në *Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe*¹⁵, as në *Fjalorin e shqipes së sotme*¹⁶, as në *Fjalorin e gjuhës shqipe*¹⁷.

Ne jemi ndalur vetëm në gjendjen e pasqyruar në Fjalor. Shembujt e mëposhtëm e tregojnë këtë dallim ndërmjet mbiemrave prejppjesorë dhe mbiemrave me -shëm.

DËSHPËRÛAR (i) mb. 1. Që është dëshpëruar. Brengosur (i). Vterosur (i) shumë i dëshpëruar. Zemërplagosur shumë i dëshpëruar. Pashpresë (i). Shpresëprerë. Shpresëhumbur. Shpresëshuar. Buzëkyçur. *E gjeti buzëkyçur sa s'thuhet, dhe ashtu e la, në dëshpërim.* (Let. art.). 2. Që shpreh dëshpërim. Brengosur (i). Vterosur (i). *Shikimi i tij i vterosur binte herë mbi njërin e herë mbi tjetrin, si të donte të gjente diku ngushëllim.* (Let. art.)

DËSHPËRÛESHËM (i) mb. → Dëshpërues,-e mb. (DËSHPËRÛES, -E mb. Që të dëshpëron. Dëshpërueshëm (i).)

Por siç thotë më sipër P. Haxhillazi, procesi është i papërfunduar. Shqipja e sotme ka në përdorim mbiemra prejppjesorë që kanë kuptimin e mbiemrave me –shëm, ndaj dhe marrëdhëniet sinonimike i vendos me këta mbiemra:

DETYRÛAR (i) mb. → Detyrueshëm (i) mb.

DETYRÛESHËM (i) mb. Që duhet bërë a që duhet zbatuar patjetër, që bëhet me detyrim. Detyruar (i). Arsimi 8-vjeçar është i detyruar, por në Malësinë e Madhe shumë fëmijë janë ngjuar dhe e kanë braktisur shkollën. (Pub.)

Por rasti më i shpeshtë është kur secili tip ka në strukturën e vetë semantike sinonimike mbiemrin tjetër. Po japim dy shembuj, i pari ku mbiemri prejfoljor me -shëm ka mbiemra prejppjesorë, dhe i dyti, ku mbiemri prejppjesor ka mbiemra prejfoljorë me –shëm:

PËRSHTÁTSHËM (i) mb. Që i plotëson kërkesat për diçka; që i shkon mirë diçkaje; që vlen për një punë. Favorshëm (i). Volitshëm (i). Duhur (i). - *Çdo gjë duhet bërë në kohën e duhur, - vërejtë, jo pa qëllim, Genci.* (Let. art.). Praktik. *Përdorimi i kësaj metode mjaft praktike do t'i japë frytet e veta.* (Pub.). Qëlluar (i). *Janë të shumta e fort të qëlluara në poemë mjetet e njohura artistike, si antiteza e hiperbola, krahasimet e metaforat, sikur mund të shihet nga citatat e mësipërme.* (Let. shkenc.). Goditur (i). *Zgjidhje më të goditur nuk priste, prandaj pranoi menjëherë.* (Let. art.). Gjetur (i). *Është një detaj i gjetur që përmbush mirë synimin e autorit.* (Pub.). Bukur (i) fig. *Është rast i bukur për ta shfrytëzuar. S'besoj të vijë më në dorë.* (Let. art.).

RRËMBÛYER (i) mb. 1. Që është rrëmbyer, që është marrë me forcë. Grabitur (i). Zaptuar (i) bised. Një problem i mprehtë social sot është problemi i tokave të zaptuara me forcë nga individë që përfitojnë nga dobësia e shtetit. (Pub.). 2. → Rrëmbyeshëm (i)₁ mb. 3. Që bëhet me rrëmbim. Rrëmbyeshëm (i). Shpejtuar (i). Nxituar (i). Në gjykojmë se një veprim i tillë do të ishte i nxituar e me pasoja të paparashikueshme për të ardhmen. (Pub.).

¹³ Shih më gjerë Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe, Tiranë, 2004.

¹⁴ Shih më gjerë *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1954.

¹⁵ Shih më gjerë Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980.

¹⁶ Shih më gjerë *Fjalor i shqipes së sotme*, Tiranë, 1984 / 2002.

¹⁷ Shih më gjerë *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.

EVIS HUDHËRA

4. Që i bën punët me rrëmbim; që nuk përmbahet. Rrëmyeshëm (i). Nxituar (i). Ngutshëm (i). – Të bajmë ndonji muhabet tjetër, se është marre me u marrë me punë të një vajze tre burra. – Je i ngutshëm, Zymer, - tha Hafizi. – Duhet të flasim pak patjetër. (Let. art.). Ngutur (i). Vrullshëm (i). – Ishte njeri i vrullshëm dhe, si i themi na, babahovi, e asnji punë nuk e qitte në krye. (Ligj. fol.). Turrshëm (i). Papërmbajtur (i). Pamatur (i). Kryekërcyer shumë i rrëmbyer.

Pra mbiemrat prejpesorë dhe ata prejfoljorë që mbarojnë me –shëm kanë një vlerë të padiskutueshme, sepse te ta gjejmë shumëllojshmëri kuptimesh, përdorimesh e thëniesh me hapësirë gjeografike, me thellësi kohore, me përkatësi kulturore të larmishme.

BIBLIOGRAFI

- Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2002, f. 155.
- Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2002, f. 156.
- Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, Tiranë, 2002, f. 158.
- P. Haxhillazi, *Vëzhgime mbi mbiemrat foljorë me prapashtesën –shëm në gjuhën shqipe*, në “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, II, Tiranë, 1972, f. 257-274.
- J. Thomai, *Formimi i fjalëve dhe prejardhja kuptimore në gj. shqipe*, SF, 3, 1983, f. 54.
- V. Memisha, *Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpesorë në gjuhën shqipe*, Gjirokastër, 1999, f. 88.
- V. Memisha, *Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpesorë në gjuhën shqipe*, Gjirokastër, 1999, f. 115.
- V. Memisha, *Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpesorë në gjuhën shqipe*, Gjirokastër, 1999, f. 99.
- Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, Tiranë, 2002, f. 265.
- Gramatika e gjuhës shqipe*, 1, Tiranë, 2002, f. 270.
- P. Haxhillazi, *Vëzhgime mbi mbiemrat foljorë me prapashtesën –shëm në gjuhën shqipe*, në “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, II, Tiranë, 1972, f. 271.
- Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004.
- Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1954.
- Fjalor i gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1980.
- Fjalor i shqipes së sotme*, Tiranë, 1984 / 2002.
- Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.